

GJYKATA E QARKUT NË PEJË

P.nr. 5/10

Datë 24 Maj 2011

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E QARKUT NË PEJË, me trupin gjykues të përbërë nga gjyqtari i EULEX-it Ingo Risch si Kryetar i Trupit Gjykues, Gjyqtari i EULEX-it Malcolm Simmons dhe Gjykatësi vendor Gëzim Pozhegu si anëtarë të panelit, të ndihmuar nga Procesmbajtësi Jacqueline Ryan, në rastin penal kundër të akuzuarit

HALIM BAJRAKTARI, i biri i Ethem dhe Hola-mbiemri i vajzërisë Rrustemi, i lindur me 03 Nëntor 1957 në fshatin Klinë e Epërme, të Komunës së Skenderajit, i martuar, baba i gjashtë fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme ekonomike, teknik i ekonomisë nga profesioni, të gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar i Kosovës, ka qenë në paraburgim që nga 23 Marsi 2006 deri më 10 Nëntor 2006, i akuzuar në bazë të Aktakuzës PP. nr. 147/06, të datës 13 Korrik 2006, e ndryshuar me 19 Maj 2011, me vepër penale *Vrasje* në kundërshtim me Nenin 146 të Kodit Penal të Kosovës.

Pas mbajtjes së seancave të shqyrtimit kryesor publik me 21 Mars, 19 dhe 24 Maj 2011, në prani të të akuzuarit Z. Halim Bajraktari dhe avokatit të tij mbrojtës Z. Mustafa Radoniqi (jo i pranishëm gjatë shpalljes së aktgjykimit), Prokurorit Publik Z. Ali Uka dhe Palës së dëmtuar Valmira Sejdiu, prezent me 21 Mars 2011 dhe 24 Maj 2011, pas këshillimit dhe votimit të trupit gjykues të mbajtur me 24 Maj 2011, bazuar në Nenin 391, Paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), me 24 Maj 2011, sipas Nenit 392, Paragrafi 1 të KPPK-së, shpall publikisht këtë

AKTGJYKIM

Në kuptim të nenin 390 (3) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, Halim Bajraktari

LIROHET

Sepse nuk është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën për të cilën është akuzuar sipas Aktakuzës.

Shpenzimet e procedurës penale, sipas nenit 99, paragrafi 2, nën paragrafi 1 përmes paragrafit 5 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm "KPPK"), shpenzimet e nevojshme të të pandehurit dhe kompensimi si dhe shpenzimet e nevojshme të përfaqësuesit të autorizuar do të paguhet nga mjetet buxhetore.

Arsvetimi

Sfondi Procedural

Me 14 Korrik 2006, Prokurori Publik i Qarkut në Pejë ka parashtruar aktakuzën PP.nr. 147/06 të datës 13 Korrik 2006 kundër Halim Bajraktarit, duke e akuzuar atë për *Vrasje* sipas Nenit 146 të KPPK-së, në lidhje me vrasjen e Bedri Sejdiut. Aktakuza është konfirmuar me 14 Shtator 2006.

Shqyrtimi kryesor është mbajtur me 06, 07, 08, 09 dhe 10 Nëntor 2006 në rastin numër P.nr.499/06. Pas përfundimit të gjykimit, me 10 Nëntor 2006 i pandehuri është shpallur fajtor për *Vrasje* e kryer në tejkalim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme sipas nenit 146 në lidhje me nenin 8, paragrafi 3 i KPK-së dhe i dënuar me katër (4) vjet burgim.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke vendosur në bazë të kërkesave të Prokurorit Publik, Avokatit Mbrojtës dhe palës së dëmtuar, e ka anuluar aktgjykimin e shkallës së parë dhe e ka kthyer rastin për ri-gjykim, përmes aktvendimit AP.nr. 178/07 të datës 22 Gusht 2007.

Në ri-gjykim rasti është proceduar me numër P.nr. 625/07. Ri-gjykimi është mbajtur me 11, 12 dhe 13 Qershor 2008. Pas përfundimit të gjykimit, me 13 Qershor 2008, i pandehuri është gjetur fajtor për *Vrasje* në tejkalim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme sipas Nenit 146 në lidhje me Nenin 8 paragrafi 3 të KPK-së dhe është dënuar me tre (3) vite dhe gjashtë (6) muaj burgim.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke vendosur sipas kërkesës së Prokurorit Publik, Avokatit mbrojtës dhe palës së dëmtuar, e ka anuluar aktgjykimin e shkallës së parë dhe e ka caktuar rastin për ri-gjykim përmes aktvendimit AP.nr. 36/09 të datës 25 Nëntor 2009.

Rasti është regjistruar sërish në Gjykatën e Qarkut në Pejë nën numrin P.no. 5/10.

Me 22 Dhjetor 2010, Kryetari i Asamblesë së Gjykatësve të EULEX-it, duke vendosur sipas kërkesës së Kryetarit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, pas seancës, ka vendosur që ta merr rastin dhe ta caktojë në kompetencë të gjyqtarëve të EULEX-it për procedim të mëtejshëm.

Kompetencat dhe Përbërja e Trupit Gjykses

Në përputhje me Nenin 23, paragrafi 1 të KPPK-së, Gjykatat e Qarkut do ta kenë kompetencën për të gjykuar, në shkallë të parë, veprat penale të dënueshme me më së paku pesë vjet burgim apo me burgim afatgjatë.

Në këtë rast, i akuzuari është akuzuar me *Vrasje*, në kundërshtim me Nenin 146 të KPK-së, e dënueshme me së paku pesë (5) vite burgim. Andaj, Gjykata e Qarkut në Pejë e ka kompetencën për të gjykuar rastin.

Vepra penale, sipas aktakuzës, është bërë në Istog, e cila është përbrenda terrorit të Komunës së Pejës. Andaj, në përputhje me Nenin 27, paragrafi 1 i KPPK-së, Gjykata e Qarkut në Pejë e ka kompetencën territoriale që ta gjykoj këtë rast.

Meqë ky rast është caktuar në kompetencë të gjyqtarëve të EULEX-it, me vendimin e Kryetarit të Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it e datës 22 Dhjetor 2010, trupi gjykues është përbërë nga dy gjyqtarë të EULEX-it dhe një gjykatës vendor sipas Nenit 3.7 të Ligjit mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë.

Asnjëra nga palët nuk e ka kundërshtuar përbërjen e trupit gjykues.

Seancat e Shqyrtimeve Kryesore

Shqyrtimi kryesor është mbajtur i hapur për publik me 21 Mars, 19 dhe 24 Maj 2011 ne prani të të akuzuarit Halim Bajraktari dhe avokatit të tij mbrojtës Mustafa Radoniqi (jo i pranishëm gjatë shpalljes së aktgjykimit), Prokurorit Publik Ali Uka, palës së dëmtuar Valmira Sejdiu (e pranishme me 21 Mars dhe 24 Maj 2011).’

Në përputhje me Nenin 15 të KPPK-së, përkthyesit ndërkombëtarë kanë përkthyer procedurat gjyqësore dhe të gjitha dokumentet relevante për gjykim nga gjuha Angleze në gjuhën Shqipe dhe e kundërta, sipas nevojës.

Provat e administruara gjatë shqyrtimit kryesor

Gjatë shqyrtimit kryesor, me 19 Maj 2011 dëshmitari ekspert/patologu Dr. Arsim Gërxhaliu është marrë në pyetje.

Me pajtimin e palëve, deklaratat e dëshmitarëve të dhëna në procedurat e mëparshme janë konsideruar si të lexuara, sipas nenit 367 të KPPK-së. Deklaratat e dëshmitarëve janë si në vijim:

1. Feriz Fejza
 - 23 Mars 2006 (Deklarata e dhënë para Policisë),
 - 11 Prill 2006 (Deklarata e dhënë para Prokurorit)
 - 09 Nëntor 2006 (Dëshmia gjatë Shqyrtimit të Parë Kryesor);

2. Mane Januzaj
 - 23 Mars 2006 (Deklarata e dhënë para Policisë),
 - 13 Qershor 2006 (Deklarata e dhënë para Prokurorit),
 - 08 Nëntor 2006 (Dëshmia gjatë Shqyrtimit të Parë Kryesor);

3. Agim Fejza
 - 23 Mars 2006 (Deklarata e dhënë para Policisë),
 - 11 Prill 2006 (Deklarata e dhënë para Prokurorit),
 - 09 Nëntor 2006 (Dëshmia gjatë Shqyrtimit të Parë Kryesor),
 - 12 Qershor 2008 (Dëshmia gjatë shqyrtimit të dytë Kryesor);
4. Bislim Sejdiqaj
 - 23 Mars 2006 (Deklarata e dhënë para Policisë),
 - 11 Prill 2006 (Deklarata e dhënë para Prokurorit),
 - 06 Nëntor 2006 (Dëshmia gjatë Shqyrtimit të Parë Kryesor),
 - 11 Qershor 2008 (Dëshmia gjatë shqyrtimit të dytë Kryesor);
5. Kadri Pepaj
 - 23 Mars 2006 (Deklarata e dhënë para Policisë),
 - 11 Prill 2006 (Deklarata e dhënë para Prokurorit),
 - 07 Nëntor 2006 (Dëshmia gjatë Shqyrtimit të Parë Kryesor),
 - 11 Qershor 2008 (Dëshmia gjatë Shqyrtimit të Dytë Kryesor);
6. Faik Sejdiu
 - 23 Mars 2006 (Deklarata e dhënë para Policisë),
 - 11 Prill 2006 (Deklarata e dhënë para Prokurorit),
 - 06 Nëntor 2006 (Dëshmia gjatë Shqyrtimit të Parë Kryesor);
7. Blerim Rama
 - 23 Mars 2006 (Deklarata e dhënë para Policisë),
 - 11 Prill 2006 (Deklarata e dhënë para Prokurorit),
 - 06 Nëntor 2006 (Dëshmia gjatë Shqyrtimit të Parë Kryesor),
 - 11 Qershor 2008 (Dëshmia gjatë Shqyrtimit të Dytë Kryesor);
8. Osman Aliqaj
 - 23 Mars 2006 (Deklarata e dhënë para Policisë),
 - 11 Prill 2006 (Deklarata e dhënë para Prokurorit),
9. Sofi Haxhaj
 - 23 Mars 2006 (Dëshmia e dhënë para Policisë),
 - 13 Qershor 2006 (Deklarata e dhënë para Prokurorit),
 - 08 Nëntor 2006 (Dëshmia gjatë Shqyrtimit të Parë Kryesor),
10. Gani Rugova
 - 29 Mars 2006 (Deklarata e dhënë para Policisë),
 - 21 Prill 2006 (Deklarata e dhënë para Prokurorit),
 - 06 Nëntor 2006 (Dëshmia gjatë Shqyrtimit të Parë Kryesor);
11. Valmir Loshi
 - 29 Mars 2006 (Deklarata e dhënë para Policisë),
 - 21 Prill 2006 (Deklarata e dhënë para Prokurorit),
 - 07 Nëntor 2006 (Dëshmia gjatë Shqyrtimit të Parë Kryesor);
12. Bajram Sejdiu
 - 01 Prill 2006 (Deklarata e dhënë para Policisë),
 - 05 Maj 2006 (Deklarata e dhënë para Prokurorit),
 - 06 Nëntor 2006 (Dëshmia gjatë Shqyrtimit të Parë Kryesor),
 - 11 Qershor 2008 (Dëshmia gjatë Shqyrtimit të Dytë Kryesor);
13. Valmira Sejdiu
 - 13 Prill 2006 (Deklarata e dhënë para Prokurorit),

- 06 Nëntor 2006 (Dëshmia gjatë Shqyrtimit të Parë Kryesor),
- 11 Qershor 2008 (Dëshmia gjatë Shqyrtimit të Dytë Kryesor);
- 14. Rrahim Shatri 05 Maj 2006 (Deklarata e dhënë para Prokurorit)
- 15. Adem Dervishaj
 - 05 Maj 2006 (Deklarata e dhënë para Prokurorit)
 - 12 Qershor 2008 (Dëshmia e dhënë gjatë shqyrtimit të Dytë Kryesor);
- 16. Dr. Arsim Gërxhaliu
 - 23 Korrik 2006 (Deklarata e dhënë para Prokurorit),
 - 08 Nëntor 2006 (Dëshmia gjatë Shqyrtimit të Parë Kryesor),
- 17. Hava Sejdiu 01 Prill 2006 (Deklarata e dhënë para Policisë);
- 18. Armend Tahiri 09 Maj 2006 (Deklarata e dhënë para Policisë);

Dëshmitë e dokumentuara

- Raport i Policisë i datës 23 Mars 2006 e përpiluar nga Zyrtari Policor Fehmi Fazliu
- Raport Policor i datës 23 Mars 2006 i përpiluar nga Zyrtari Policor Mehmet Fetahaj
- Raport Policor i datës 08 Shkurt 2005¹ përpiluar nga Zyrtari Policor Ismet Dervishaj
- Raport Policor i datës 23 Mars 2006 përpiluar nga Zyrtari Policor Ajet Halimaj
- Raport Policor i datës 23 Mars 2006 përpiluar nga Dzevahira Huremovic
- Raport Policor i datës 24 Mars 2006 përpiluar nga zyrtari Policor Xhavit Abdyli
- Raportet e Krimin të Policisë, rasti numër 2006-DI-097 e datës 24 Mars 2006 me shtesën e 31 Marsit 2006, 19 Prill 2006 dhe 11 Maj 2006
- Raport i Policisë i datës 09 Maj 2006 përpiluar nga Zyrtari Policor Enis Boshtrakaj
- Raporti nga Vendi i Krimin, skica nga vendi i krimin, legjenda dhe fotografitë nga ekzaminimi i autopsisë
- Raporti i autopsisë MA 06 – 058 e datës 24 Mars 2006 dhe fotografitë nga ekzaminimi i autopsisë
- Raporti i Ekzaminimit të Automjetit i datës 31 Mars 2006 i përpiluar nga Zyrtari Policor Blerim Tigani
- Fotografitë e thikës së dorëzuar nga ana e të pandehurit
- Fotografitë e pantallonave të të pandehurit të përgatitura nga Zyrtari Policor Elhamedin Nallbani
- Raporti Mjekësor i të pandehurit Halim Bajraktari i datës 23 Mars 2006 i lëshuar nga Qendra Emergjente e Qendrës së Klinikës Universitare në Prishtinë
- Raporti i panelit të tre mjeko ligjorëve ekspert i datës 29 Prill 2008, lidhur me ekzaminimin dhe analizën e raportit të autopsisë.

¹ Data në këtë raport është e qartë se është një gabim shtypi, meqë përmbajtja e raportit flet për ngjarjen që ka ndodhur me 23 Mars 2006

Gjendja Faktike

Pas marrjes së dëshmive trupi gjykues është bindur se gjendja faktike ka ndodhur si në vijim:

Me 23 Mars 2006, rreth orës 12:45, në rrugën “Rruga e Koshares” në Istog, i akuzuari Halim Bajraktari e ka takuar rastësisht të ndjerin Bedri Sejdiu dhe ata kanë ecur së bashku në drejtim të makinës së të akuzuarit. Në fillim ata kanë folur në lidhje me punët e biznesit në të kaluarën e cila ka shpënë në një fjalosje në lidhje me pretendimet reciproke financiare. I akuzuari ka pasur për qëllim që të largohet nga vendi i ngjarjes, ka hyrë në makinën e tij të parkuar në anën e vozitësit të makinës dhe ishte duke u nisur për të shkuar. Para se ai të filloj që të lëviz, i ndjeri Bedri ka hyrë në ulësen e përparme. Brenda makinës fjalosja u përshkallëzua dhe u zhvillua në një përleshje fizike në mes të të akuzuarit dhe të ndjerit Bedri, duke rezultuar me lëndime të dyanshme. Gjatë kësaj përleshje Bedri Sejdiu ka nxjerrë thikën e tij të xhepit dhe e ka therur të akuzuarin në këmbën e tij të majtë, dy herë, dhe ka shkaktuar plagë me gjakderdhje.

I akuzuari ka reaguar duke e marrë thikën nga dora e Bedriut, ka marrë një prerje thike në gishtin e madh të djathtë të dorës, por ia ka arritur që ta marrë thikën në dorën e tij dhe me të ka therur katër herë trupin e të ndjerit Bedri, duke shkaktuar po ashtu plagë me gjakderdhje: 1) në abdomen, 2) në pjesën e përparme të pjesës së poshtme të këmbës së majtë, 3) në pjesën e jashtme të sipërme të krahut të majtë dhe 4) në anën e pasme të bërrylit të majtë. Këto lëndime, në të ndjerin Bedri ishin shkaktuar brenda makinës së të akuzuarit gjatë përleshjes.

Për më tepër, i ndjeri Bedri ka marrë lëndime në fytyrën e tij si Gërvishtje, shiko faqen 2 të Raportit të autopsisë MA-06-058 nën pikën A) 1 gjer në 5 dhe fotografitë 04 dhe 05 nga MPF zyra e ekzaminuesit mjekësor e datës 24 Mars 2006, dhe pika B) nën pikën 7 në faqen tre të Raportit të Autopsisë dhe fotoja përkatëse numër 16 dhe 17 në lidhje me gërvishtjen e zgjatur vertikale. Kur ka dëshmuar, patologu nuk ka mundur ta përjashtoj mundësin se ato gërvishtje janë shkaktuar kur i ndjeri ka rënë në tokë apo kur është ngritur nga toka para se të dërgohet për në spital. Trupit gjykues i është dashur që ta lërë çështjen të pavendosur se si tani i ndjeri Bedri i ka marrë lëndime në fytyrën e tij dhe të gërvishturën e gjatë 7 cm në anën e pasme të djathtë të gjoksit (lëndimi nr. 6 i raportit të autopsisë). Por asnjëra nga to nuk ishte shkaktuar nga përdorimi i shufrës së hekurit apo ndonjë instrument i njëjtë nga i akuzuari.

Gjersa Bedriu ka rënë në tokë, i akuzuari është larguar nga vendi i ngjarjes në këmbë. Kalimtarët që kalonin në këmbë janë kujdesur për Bedri Sejdiun, e kanë vendosur atë në pozicion të shtrirë dhe kanë thirrur policinë të cilët kanë urdhëruar transportin e tij për në spital. Kur kanë arritur atje, mjekët kanë konstatuar se ai kishte vdekur.

Asnjë nga lëndimet e Bedri Sejdiut duke përfshirë edhe gjakderdhjen e shkaktuar nga i akuzuari, nuk kanë qenë vdekjeprurëse dhe nuk kanë shpënë në vdekjen e Bedri Sejdiut, e as edhe nëse rezultati i të gjitha lëndimeve vlerësohet së bashku. Asnjë organ vital apo enë gjaku e të ndjerit nuk kanë qenë të përfshira nga lëndimet dhe po ashtu asnjë humbje e madhe e gjakut e papritur nuk ka kontribuar në vdekjen e tij.

Shkaku i vdekjes ka qenë çrregullimet e zemrës, në veçanti anomalitë e arterieve koronare të ndjerit. Nuk ka indikacion se i akuzuari ka ditur apo të ketë pasur dijeni në lidhje me këto tkurrje jo normale të zemrës së Bedri Sejdiut.

Vlerësimi i provave dhe gjetjet ligjore

Trupi gjykues **nuk** e ka gjetur të akuzuarin fajtor për **veprën penale të vrasjes, neni 146 i KPK-së**, sepse kërkesat e kësaj dispozite nuk janë përmbushur.

Duke vlerësuar dëshmitë trupi gjykues është i bindur se i akuzuari në asnjë kohë nuk ka vepruar me qëllim që ta privoj nga jeta viktimën Bedri Sejdiu. Edhe pse është konstatuar se i akuzuari e ka therur me thikë disa herë viktimën në ditën kritike, ai nuk e ka përdorur thikën me qëllim që ta privoj nga jeta viktimën, as me qëllim të drejtpërdrejtë (“dolus directus”) e as me qëllim eventual (“dolus eventualis”), sepse ai nuk ka pasur qëllim që ta privoj nga jeta Bedri Sejdiun e as që ai ka vepruar duke menduar se viktimë do të mund të vdes nga therja e tij. Në të kundërtën, trupi gjykues është i bindur se i akuzuari ka dashur që të shmang në çdo mënyrë që Bedriu të vdes si rezultat i përdorimit të tij të thikës. Përrjashtimi i çdo qëllimi për të vrarë duhet që të konstatohet nga karakteri i plagëve të veçanta të cilat i akuzuari i ka bërë në trupin e viktimës duke e therur atë. Raporti i autopsisë demonstroi pa dyshimin më të vogël se katër prerjet që ishin shkaktuar nga thika nuk kanë prekur asnjë organ vital, enë gjaku apo nerv vital të viktimës. Njëri nga ata goditi krahun e majtë lateral, një tjetër është vendosur poshtë kafazit të brinjëve në të djathtë, një tjetër poshtë gjurit të majtë dhe njëra poshtë bërrylit të majtë. Të gjitha therjet kanë dëmtuar vetëm lëkurën, indin hipodermik dhe indeve të dhjamosur, por asnjëra nga ato nuk ka qenë e rrezikshme për jetë, edhe nëse të katër prerjet si tërësi vlerësohen duke konsideruar efektin reciprok dhe të përbashkët të të katër lëndimeve së bashku.

Trupi gjykues ka marrë në konsiderim opsionin se i akuzuari ka tentuar që ta qëlloj kundërshtarin e tij më shumë dhe se ka dështuar rastësisht që ta lëndoj viktimën me rrezik jete, por një mundësi e tillë ekziston vetëm në teori dhe duhet që të përjashtohet. Përleshja e të akuzuarit me të ndjerin Bedri Sejdiu ka ndodhur kur ata kanë qenë shumë afër njëri tjetrit, kryesisht brenda makinës. Distanca e shkurtë vërteton se i akuzuari ka mundur lehtë ta godasë atë në ato pjesë të trupit ku të therurat do të kishin efekt vdekje prurës – për shembull duke e therë atë në kokë, qafë apo krahë – nëse i akuzuari do të kishte dashur që ta vras Bedriun. Fakti që asnjëra nga të katër therjet nuk ka shkaktuar plagë serioze, nuk mund të sqarohet si e rastësishme në mënyrë që i akuzuari ka vepruar me qëllim që të godas organet vitale, por nuk arriti që ta bëjë atë katër herë. Një supozim i tillë do të ishte kundër të gjitha përvojave jetësore. Fakti se të katër therjet kanë qëlluar pjesët jo vitale e mbështesin supozimin se i akuzuari me qëllim i ka shënjestruar pjesët jo vitale të trupit si përgjigje ndaj therjeve të Bedriut në këmbën e majtë të të akuzuarit.

Trupi gjykues po ashtu e ka marrë në konsideratë nëse i akuzuari ka kryer veprën penale të **Vrasjes nga Pakujdesia** në kundërshtim me **Nenin 149 të KPK-së**, por edhe kjo alternativë duhet të përjashtohet.

Eksperti mjekësor Dr. Arsim Gërxhaliu, gjatë marrjes në pyetje gjatë shqyrtimit kryesor me 19 Maj 2011 në mënyrë gjithëpërfshirëse ka sqaruar se asnjë nga plagët e therjeve individuale dhe po ashtu as tërësia e të gjitha lëndimeve të shkaktuara nga i akuzuari, nuk kanë shpënë në

vdekjen e viktimës. Sipas analizës së tij viktimja ka vdekur për shkak të defekteve të lindura të zemrës së tij. Trupi gjykues i bashkohet vlerësimit të ekspertëve se lëndimet e shkaktuara nga i akuzuari nuk kanë shpënë në vdekje dhe se viktimja nuk ka vdekur nga gjakderdhja e shkaktuar nga i akuzuari. Një rezultat i ndryshëm juridik mund vetëm të konsiderohet, nëse i akuzuari para përlëshjes ka qenë i vetëdijshëm për dobësitë e zemrës së viktimës. Por nuk ka as ndonjë indikacion më të vogël se i akuzuari ka mundur të ketë dijeni për këto rrethana, meqë shihet se as anëtarët e familjes së të ndjerit apo i ndjeri vetë të kenë pasur dijeni në lidhje me këtë çrregullim.

Si rezultat duhet që të konstatohet se i akuzuari po ashtu nuk është fajtor për veprën penale vrasje nga pakujdesia.

Sa i përket raportit të autopsisë që konsideron se therjet kanë mundur që të shkaktojnë një përfshirje emocionale dhe në këtë mënyrë ka mundur që të kontribuoj në vdekjen, ky opsion po ashtu nuk do të na shpjegë në gjatjen e të akuzuarit fajtor.

Edhe nëse një përfshirje e tillë emocionale ka kontribuar në vdekjen e të ndjerit Bedri, trupi gjykues nuk e gjen të akuzuarin fajtor për shkaktimin e kësaj përfshirjeje emocionale të të ndjerit, sepse ka qenë ai i cili e ka filluar fjalosjen dhe po ashtu e ka therur të akuzuarin i pari duke përdorur thikën e tij të xhepit.

Për më tepër trupi gjykues ka konsideruar se, nëse i akuzuari do të mund të gjendet fajtor për veprën penale të **Lëndimeve të Rënda Trupore**, në kundërshtim me **Nenin 154 të KPK-së** apo së paku **Lëndime të Lehta Trupore**, në kundërshtim me **Nenin 153 të KPK-së**. Trupi gjykues po ashtu e ka përjashtuar këtë mundësi.

Të gjitha lëndimet e të ndjerit Bedri që ishin shkaktuar nga i akuzuari brenda makinës së tij janë të justifikuara nga **Mbrojtja e Nevojshme – Neni 8 i KPK-së** dhe nuk përbëjnë vepër penale.

Nuk ka dëshmitarë që kanë dhënë dëshmi nga të cilët përlëshja brenda makinës ishte iniciuar dhe se si kanë kontribuar ata në zhvillimin e përlëshjes. Por, nga gjendja faktike, trupi gjykues është i bindur jashtë çdo dyshimi se ka qenë i ndjeri Bedri që e ka përdorur thikën e tij të xhepit i pari për ta therur të akuzuarin. Kjo është përcaktuar sipas deklaratës të akuzuarit e cilat përputhet me njollat e gjakut në ulësen e shoferit në makinën e të akuzuarit. Këto njolla gjaku mund të sqarohen lehtë nga dy prerjet e thikës në këmbën e tij të cilat i akuzuari nuk ka mundur që t'ia shkaktojë vetes. I vetmi sqarim logjik është se i ndjeri Bedri e ka therur të akuzuarin dy herë. Deklarata e mëtejme e të akuzuarit se ai e ka marrë thikën nga i ndjeri është përcaktuar me plagët e tija të prerjes në gishtin e madh të dorës së djathtë. Nga logjika një lëndim i tillë është i arsyeshëm kur dikush rrëmben për ta nxjerrë thikën nga dora e tjetërkujt.

Përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, ka qenë i ndjeri Bedri i cili e ka filluar fjalosjen duke thënë se i akuzuari i ka pasur atij borxh në të holla. Dhe po ashtu është e padiskutueshme se viktimja ka hyrë në makinën e të akuzuarit kur ai ishte duke e lenë vendin e parkingut, dhe ka vazhduar që të kërkojë para nga i akuzuari, përlëshja ka eskaluar dhe i ndjeri Bedri e ka therur të akuzuarin dhe e ka goditur në këmbën e tij të majtë. Njolla e gjakut në ulësen e shoferit të makinës së të akuzuarit e dëshmon këtë fakt. Plaga e prerjes në gishtin e të akuzuarit se paku *prima facie* e

përcakton dëshminë se i akuzuari e ka marrë thikën nga viktima dhe është lënduar me këtë rast në dorën e tij.

Trupi gjykues ka marrë në konsideratë mundësinë se i akuzuari ka kaluar kufirin e mbrojtjes së nevojshme. Ky do të ishte rasti, nëse i akuzuari do ta kishte lënduar viktimën duke përdorur një mjet sikurse që është shufra metalike dhe/ose nëse ai e kishte rrahur atë derisa viktima ishte fizikisht jo në gjendje për ta vazhduar përleshjen me të akuzuarin, në veçanti, nëse ai do të ishte i shtrirë pak a shumë pa ndjenja në tokë.

Deklaratat e dëshmitarëve Sofije Haxhijaj dhe Mone Jonuzaj, Osman Alijaj dhe Agim Fejza mund të shpijnë në konkluzion të tillë, por deklaratat e tyre janë diametralisht në kundërshtim me raportin e autopsisë dhe sqarimi i bindshëm i ekspertit mjekësor për patologji, Dr. Arsim Gërxhaliut, i cili ka theksuar se çdo përdorimi i shufrës metalike apo një instrumenti të krahasueshëm, do ti kishte shkaktuar hematomë personit të lënduar. Sipas ekspertizës mjekësore, i ndjeri Bedri nuk ka pasur hematomë e cila do të ishte shkaktuar nga një shufër metalike apo një instrument i ngjashëm në trupin e tij. Në veçanti sa i përket lëndimeve të përshkruara në foto dokumentacionin e raportit të autopsisë, nga fotoja numër 16 dhe 17, sqarimi i ekspertit mjekësor Dr. Arsim Gërxhaliu, ka përjashtuar se kjo është shkaktuar nga një shufër metalike apo ndonjë instrument i ngjashëm dhe sipas supozimit të tij, ky lëndim i ka karakteristikat e një gërvishtjeje, e cila mund të shkaktohet kur personi rrëzohet në tokë.

Trupi gjykues nuk ka dyshime në përshkrimin e mjekut dhe ndjek konkluzionin e tij, sepse dëshmitarët e lartpërmendur do të kenë gabuar kur kanë përshkruar përdorimin e shufrës metalike. Sipas raportit mjekësor të datës 23 Mars 2006 të qendrës klinike universitare në Prishtinë, prot.nr. 8098, ka pasur hematomë në anën e majtë të trupit të të akuzuarit, poshtë sqetullës. Ky lëndim i të akuzuarit ka mundur që të shkaktohet nga një shufër metalike apo instrument i krahasueshëm dhe i dëshmuar nga ana e dëshmitarëve të lartë përmendur të cilët është e qartë se e kanë përzier faktin se kush e ka rrahur kënd. Së paku deklaratat e këtyre dëshmitarëve nuk japin arsye për të dyshuar se çka ka elaboruar dhe sqaruar eksperti mjekësor Dr. Arsim Gërxhaliu, dhe trupi gjykues i gjen gjetjet e tija si të besueshme.

Sa i përket deklaratave të të gjithë dëshmitarëve tjerë, asnjë nga dëshmitë e tyre nuk është e kualifikuar që ta sfidojë evaluimin e lartpërmendur dhe nuk mund që të shpije për ta gjetur të akuzuarin fajtor. Deklarata e Kadri Pepajt i cili është marrë si taksist nga ana e të akuzuarit, pasi që incidenti kishte ndodhur, i cili ka deklaruar se ka dëgjuar të akuzuarin duke folur me dikë në telefon dhe duke thënë se “...e kam bere nje llapsus, e kam bere mut...” mund të shihet si një indikacion i tejkallimit të kufijve të mbrojtjes së nevojshme, por nuk mund të konsiderohet si një element i esencial që do të shpinte në fajin e të akuzuarit.

Në lidhje me pyetjen se pse i akuzuari i ka ndërruar pantallonat e tij në tualetin e një pompe të benzinës, në bindje të trupit gjykues, ai ka vepruar ashtu sepse pantallonat e tij kanë qenë plot me gjak dhe ai ka gjetur pantallona tjera apo një palë pantallona i ish-in ofruar atij, për ta bërë këtë ndryshim të mundshëm. Në pyetjen e mëtejme se përse edhe këto palë pantallona tjera ishin të njolloshura me gjak, dhe kjo ka qenë e vërejtur edhe nga ana e policisë kur ai është dorëzuar, kjo nuk ka qenë diçka e pazakontë sepse plagët e therjes së të akuzuarit vazhdonin që të gjakosnin dhe kanë shkaktuar po ashtu njolla gjaku tek pala tjetër e pantallonave.

Trupi gjykues ka konsideruar po ashtu veprën penale të *Braktisja e Personave të Paaftë* – Neni 157 i KPPK-së, por në këtë rast ka qenë e paarsyeshme për të akuzuarin që të qëndroj në vendin e krimit. Duke marrë në konsideratë gjithë situatën, i akuzuari kishte të drejtë që ta lëshoj vendin e ngjarjes dhe që ti jep rëndësi mjekimit të plagëve të tija, duke marrë parasysh faktin se ka pasur persona përreth të cilët kanë mundur që ti ndihmojnë të ndjerit Bedri.

Shpenzimet procedurale

Meqë i akuzuari është liruar nga akuza, shpenzimet e procedurave penale do të paguhen nga buxheti i Kosovës. Për më tepër, shpenzimet e nevojshme të të pandehurit dhe kompensimet dhe shpenzimet e nevojshme të avokatit mbrojtës, do të paguhen nga burimet buxhetore, sipas Nenit 99, paragrafi 2 të KPPK-së.

GJYKATA E QARKUT NË PEJË

P.nr.5/10

Me Datë 24 Maj 2011

Anëtar i trupit gjykues

Malcolm Simmons

Anëtar i trupit gjykues

Gëzim Pozhegu

Kryetar i trupit gjykues

Ingo Risch



Procesmbajtës

Jacqueline Ryan

Këshilla Ligjore

Një ankesë mund të paralajmërohet në afat brenda 8 ditësh nga shpallja e këtij aktgjykimi dhe do të parashtrohet në gjykatën e shkallës së parë, sipas Nenit 400, paragrafi 1 i KPPK-së.

Personat e autorizuar mund të parashtrojnë një ankesë në formë të shkruar kundër këtij aktgjykimi dhe atë përmes gjykatës së Qarkut në Pejë, Gjykatës Supreme të Kosovës, brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga dita kur kopja e aktgjykimit është shërbyer, sipas Nenit 398, paragrafi 1 i KPPK-së.